



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Konkurs “Profesionistët e rinj për zhvillimin ndërkuftar” Kosovë - Shqipëri

2015-12-01 15:38:00



Njoftohen të gjithë të interesuarit për aplikim në konkursin “Profesionistët e rinj për zhvillimin ndërkuftar” Shqipëri-Kosovë se data e regjistrimit për konkursin është shtyrë për në 10 Janar 2016.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Zhvillimit Urban të Republikës së Shqipërisë, shpallin konkursin me temën: “Profesionistët e rinj për zhvillimin ndërkuftar” me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve ideale për zhvillimin hapësinor të zonave: "Shtigjet e lirisë", që shtrihet në territorin e komunave Gjakovë-Tropojë-Has dhe "Korridori i gjelbër", që shtrihet midis territorit të komunave Prizren-Kukës.

Konkursi, vjen si rezultat i punës së përbashkët të grupeve teknike të dy ministrive. Ai ka si qëllim, zhvillimin e përgjithshëm të komunave ndërkuftare dhe krijimin e mundësive për brezin e ri të profesionistëve, nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urban, që të shprehin kreativitetin e tyre në dhënien e idesë për projektet në fjalë.

Regjistrimi në konkurs, do të jetë i hapur deri më 18 dhjetor dhe mund të marrin pjesë të gjithë profesionistët deri në moshën 40 vjeç. Afati i fundit për dorëzim të projekteve është deri më 10 mars 2016.

Suksese!

Në link-et më poshtë gjeni formularin e aplikimit dhe Termat e Referencës:

http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/Konkursi_Profesionistet_KosoveShqiperi/Formular_aplikimi_011215.doc

[http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/Konkursi_Profesionistet_KosoveShqiperi/ToR - Konkurs projektimi Shq-Kos 011215.doc](http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/Konkursi_Profesionistet_KosoveShqiperi/ToR_-_Konkurs_projektimi_Shq-Kos_011215.doc)